

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Lirim i menjëhershëm nga detyra"/ Rama për Hysenin: Fajësia dhe pafajësia janë individuale, hetimet n uk janë "aktakuzë" ndaj mazhorancës - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/lirim-i-menjehershem-nga-detyra-rama-per-hysenin-fajesia-dhe-pafajesia- jane-individuale-hetimet-nuk-jane-aktakuze-ndaj-mazhorances/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:47:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 14:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	960e43295e35467028cabfe4cb3b311210b8b771cecc7d937f4e13f9d2e1e92c
TEKSTI	47b1a57440f8bd6875413ee3f0005cb280f265e50dd3a37d21b79ecd0c90462e
PAMJA	92aba2fa6d4b9cc8c0a835baecf2202bd1a7dbcf9d5cd31491d4e59960810ca

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	df681283d8393003728fdb8ed5d774c2be831a884c7426660a3d71d79a9a129c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/df681283d8393003728fdb8ed5d774c2be831a884c7426660a3d71d79a9a129c

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


YOU ARE AT: Home » "Lirim i menjëhershëm nga detyra"/ Rama për Hysenin: Fajësia dhe pafajësia janë individuale, hetimet nuk janë "aktakuzë" ndaj mazhorancës

KRYESORE

Demo

"Lirim i menjëhershëm nga detyra"/ Rama për Hysenin: Fajësia dhe pafajësia janë individuale, hetimet nuk janë "aktakuzë" ndaj mazhorancës

SEPTEMBER 22, 2026



Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas masës së arrestit shtëpiak ndaj drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni, duke deklaruar se hetimet ndaj zyrtarëve publikë nuk mund të interpretohen si një "aktakuzë" ndaj mazhorancës qeverisëse.

Rama theksoi se veprimet e organeve të drejtësisë janë pjesë e funksionimit të pavarur të sistemit dhe e zbatimit të parimit të barazisë para ligjit.

"E megjithatë, kurrësi nuk mund të jetë e vërtetë që veprimet e pavarura të drejtësisë dhe afirmimi i vijueshëm i barazisë para ligjit, të jenë njëkohësisht akt-akuza kundër pikërisht një shumice qeverisëse e cila me kurajo e me vendosmëri, ia ka çelur rrugën drejtësisë së pavarur", deklaroi Rama.

Kryeministri tha se çdo dyshim i ngritur nga organi i akuzës ndaj Hysenit duhet të hetohet dhe të zbardhet deri në fund përmes një procesi të pavarur gjyqësor. Sipas tij, drejtësia duhet të hetojë dhe të gjykojë këdo, pavarësisht funksionit apo statusit.

Rama nënvizoi se përgjegjësia penale është individuale dhe nuk mund t'i atribuohet shumicës qeverisëse për shkak të funksionit që ka mbajtur një zyrtar.

"Pafajësia ose fajësia e një bashkëpunëtori të vendosur nën akuzë është një çështje individuale përballë prokurorisë e gjykatës dhe kjo shumicë qeverisëse me mua në krye, i mbetet besnike këtij qëndrimi duke mos hyrë në meritën e asnjë çështjeje të drejtësisë dhe duke mos bërë avokatinë e askujt që përballlet me drejtësinë", tha Rama.

Ai kritikoi gjithashtu gjykimin publik të personave nën hetim përpara përfundimit të procesit gjyqësor, duke rikujtuar parimin e prezumimit të pafajësisë.

"Çdokush është i pafajshëm deri në gjykimin përfundimtar", deklaroi Rama, duke shtuar se "askush nuk është mbi ligjin".

POSTIMI I KRYEMINISTRIT RAMA

Për shkak të orareve të ndryshme ky reagim nga Nju Jorku, ku jam për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, mund të duket i vonuar dhe ndjesë për këtë.

Jam informuar lidhur me masën e arrestit shtëpiak që SPAK-u ka nxjerrë për drejtoren e Shërbimit Informativ të Shtetit, e pres që çdo dyshim i organit të akuzës të hetohet dhe zbardhet deri në fund përmes procesit të pavarur gjyqësor.

Postimet e reja

Arrestohet në Rusi një nga personat më të kërkuar...

SEPTEMBER 23, 2026

E ardhmja e Merz nën presion, 45% e...

SEPTEMBER 23, 2026

Ish-producenti i Hollywood-it Harvey...

SEPTEMBER 23, 2026

Presidentja në detyrë i ftoi në takim, familjet...

SEPTEMBER 23, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 22, 2026

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Situata financiare e një prej ish-gjigantëve të grumbullimit dhe eksportit të fruta perimeve, "Top Fruits",...

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznes të paktën 1-vjeçare

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

Na ndiq

vertetj respektit per punen one per personin e viora nysenit, si eadne po asntu pertej vieresimeve te vazhdueshme, qe ajo ka marrë nga agjencitë partnere si drejtuese e shërbimit inteligjent shqiptar, rruga pa kthim qe kemi zgjedhur është rruga e pavarësisë së organeve të drejtësisë për të hetuar e gjykuar këdoqoftë, pavarësisht statusit social apo funksionit publik.



Por po ashtu, është e pashmangshme mesa duket, qe çdo hetim apo masë e marrë nga drejtësia në adresë të personave publikë, të kthehet në një motivim për të grirë mish njeriu në mexhelisin politik e mediatik dhe për të thirrur "litarin" si në sheshet e ekzekutimit mesjetar, kohë përpara sesa gjykata të thotë fjalën e saj.

E megjithatë, kurrësesi nuk mund të jetë e vërtetë qe veprimet e pavarura të drejtësisë dhe afirmimi i vijueshëm i barazisë para ligjit, të jenë njëkohësisht akt-akuza kundër pikërisht një shumice qeverisëse e cila me kurajo e me vendosmëri, ia ka çelur rrugën drejtësisë së pavarur, në një vend ku deri para shumë pak vitesh kjo pavarësi ishte e paimagjinueshme prej shekujsh.

As mund të jenë këto zhvillime me drejtësinë baltë kundër Shqipërisë, e cila po bën në rrugën e saj të bashkimit me Europën shumëçka qe as nuk mund të imagjinohet akoma në vendet e tjera të rajonit dhe qe koha do ta çmojë më mirë se sa kushdo.

Çdokush është i pafajshëm deri në gjykimin përfundimtar po askush nuk është mbi ligjin në asnjë rast e për asnjë arsye, kështu qe unë i jam falenderues Vlora Hysenit për çdo gjë qe ka bërë si duhet në shërbim të Shqipërisë, ndërsa për gjithçka tjetër qe ka të bëjë me çështjen e sapohapur nga organet e drejtësisë, qëndrimi im mbetet po ai i ditës së parë të Reformës në Drejtësi:

Pafajësia ose fajësia e një bashkëpunëtori të vendosur nën akuzë është një çështje individuale përballë prokurorisë e gjykatës dhe kjo shumicë qeverisëse me mua në krye, i mbetet besnike këtij qëndrimi duke mos hyrë në meritën e asnjë çështjeje të drejtësisë dhe duke mos bërë avokatinë e askujt qe përballlet me drejtësinë.

Lirimi nga detyra i drejtores së shërbimit është i menjëhershëm, e sapo të kthehem në Tiranë dhe në konsultim me Presidentin e Republikës, do të zgjedhim drejtuesin e ri të Shërbimit Informativ të Shtetit.

Edi rama SHISH Vlora Hyseni

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.